

**LIGJ**  
**Nr. 32/2024**

**PËR DISA SHITESA NË LIGJIN NR. 15/2017, “PËR ARSIMIN DHE FORMIMIN  
PROFESIONAL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozim të një deputeti,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,

VENDOSI

Në ligjin nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, bëhen shtesat si më poshtë:

Neni 1

Pas nenit 12, “Ofruesit e AFP-së”, shtohet neni 12/1 me këtë përmbajtje:

Neni 12/1

**Programet e përbashkëta të studimit**

1. Ministria përgjegjëse për AFP-në ose institucionet publike ofruese të AFP-së/Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, me qëllim rritjen e cilësisë dhe standardeve, të kualifikimeve profesionale, kanë të drejtë të lidhin marrëveshje me institucione arsimore të huaja të njohura ndërkombëtare ose organizma ndërkombëtarë për lëshimin e diplomave/certifikatave të përbashkëta ose të dyfishta nga institucionet pjesëmarrëse.

2. Shpenzimet e mundshme për zbatimin e këtyre marrëveshjeve, sipas rastit, përballohen nga fondet buxhetore të miratuara për institucionet publike ofruese të AFP-së/Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive ose burime të tjera të ligjshme, të rregulluara me udhëzim të ministrit përgjegjës për AFP-në.

3. Efektet financiare për angazhimet në marrëveshje, kur mbulohen nga institucioni publik ofrues i AFP-së/Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, sipas parashikimeve të marrëveshjes, në rastet kur nuk u nënshtrohen rregullave të prokurimit publik, rregullohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për financat dhe ministrit përgjegjës për AFP-në. Institucionet publike ofruese të AFP-së, përpara lidhjes së marrëveshjes së bashkëpunimit dhe për hapjen e programeve të përbashkëta ose të dyfishta të studimit, marrin miratimin paraprak të ministrisë përgjegjëse për AFP-në.

Neni 2

Në pikën 4 të nenit 16, “Kualifikimet profesionale dhe nivelet përkatëse”, pas shkronjës “b” shtohen shkronjat “c” dhe “ç” me këtë përmbajtje:

“c) Me përfundimin e arsimit të mesëm profesional, i orientuar sipas drejtimeve të gjera profesionale, me kohëzgjatje 3 vite shkollore pas përfundimit të arsimit bazë, mund të përftohet niveli 3 i KSHK-së. Ky nivel arsimor përfundon me certifikatë profesionale të maturës shkollore profesionale (shkollës së mesme) dhe lejon kalimin në nivel më të lartë të arsimit profesional, në kursin urë të përgjithshëm ose në tregun e punës.

ç) Me përfundimin e arsimit të mesëm profesional, i orientuar sipas profileve profesionale për çdo drejtim profesional, me kohëzgjatje 1 vit shkollor, pas përfundimit të arsimit profesional bazë, mund të përftohet niveli 3 i KSHK-së. Ky nivel arsimor përfundon me certifikatë profesionale të maturës

shkollore profesionale (shkollës së mesme) dhe lejon kalimin në nivel më të lartë të arsimit profesional, në kursin urë të përgjithshëm ose në tregun e punës.”.

#### Neni 3

Në nenin 25, “Akreditimi”, pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Shpenzimet për akreditimin përballohen nga vetë institucionet ofruese të AFP-së, sipas tarifave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

#### Neni 4

##### **Dispozitë kalimtare**

Ngarkohen ministri përgjegjës për financat dhe ministri përgjegjës për AFP-në për nxjerrjen e udhëzimit sipas pikës 3 të nenit 1 të këtij ligji brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

#### Neni 5

##### **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 4.4.2024.

**Shpallur me dekretin nr. 150, datë 16.4.2024, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.**